



KOLEGJI AAB
AAB COLLEGE

Prishtinë

nr. 109/23 data: 01/03/2023



Kolegji AAB
CILËSI. LIDERSHIP. SUKSESI!

ODA E STOMATOLOGËVE
TË KOSOVËS

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

NË MES TË

ODËS SË STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS DHE IPAL "KOLEGJI AAB",
FAKULTETI I STOMATOLOGJISË

Neni 1

Oda e Stomatologëve të Kosovës dhe Fakulteti i Stomatologjisë i Kolegjit AAB (në vazhdim *Palët*) shprehin vullnetin dhe mirëkuptimin e tyre për bashkëpunim e qëndrueshëm në shkëmbimin e informacionit, fusëhën e hulumtimeve shkencore në stomatologji, promovimin e shëndetit oral, trajnimeve dhe edukimit të vazhdueshëm profesional (EVP)

Neni 2

Kjo marrëveshje lidhet si shprehje e gatishmërisë për bashkëpunim dhe vullnet të mirë ndërmjet *Palëve*, me mirëbesim dhe përpos zotimeve të kësaj marrëveshje (fushave të bashkëpunimit), palët nuk kanë asnjë detyrim tjetër ndaj njëri tjetrit

Neni 3

Palët dakordohen të mbështesin organizimin e aktiviteteve profesionale dhe shkencore të përbashkëta në fushën e EVP duke përfshirë ligjerata, trajnime, kongrese/konferenca, tubime shkencore, seminare, simpoziume dhe forma të tjera të avancimit profesional dhe shkencor në nivel vendi.

Neni 4

Oda e Stomatologëve të Kosovës merr angazhimin për të njohur dhe akredituar format e ndryshme të aktiviteteve të ndryshme në kuadër të EVP që Fakulteti i Stomatologjisë i Kolegjit AAB organizon dhe është bartës i tyre.

Neni 5

Palët zotohen që me marrëveshje të ndërsjellët t'i ndajnë detyrat dhe obligimet e përgjithshme në rastet kur organizimi i aktiviteteve profesionale e shkencore në kuadër të EVP-së është i përbashkët, ndarja e shpenzimeve për organizim të aktiviteteve profesionale e shkencore duke përfshirë të gjitha shpenzimet bëhet sipas anekseve që i shtohen marrëveshjes ose me miratim nga ana e zyrës së financave.

Neni 6

Palët zotohen të bashkëpunojnë në fushën e publikimeve dhe promovimit të shëndetit oral dhe kujdesit stomatologjik.

Neni 7

Ky memorandum lidhet në afat të pacaktuar. *Palët* mund të pajtohen në cdo kohë për përfundimin e këtij memorandum.

Neni 8

1. Cdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij memorandum zgjidhet me mirëkuptim mes palëve.
2. *Palët* bien dakord për format e përmirësimit të mangësive të evidentuara në mbështetje dhe bashkëpunim të ndërsjellët ndërmjet tyre.

Neni 9

Ky Memorandum i Bashkëpunimit hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij dhe ka afat 5 vjeçar.


Oda e Stomatologëve të Kosovës

KRYETARI
Prof. Dr. Blerim Kamberi



Fakulteti i Stomatologjisë

DEKANI
Prof. Ass. Dr. Astrit Kuçi



Prishtinë,

Më: 01 mars 2023